

**AKTI I THEMELIMIT
DHE STATUTI I SHOQËRISË “APRA TRADERS” SHPK**

THEMELIMI

Neni 1
Ortaku themelues

1.1 Shoqëria “APRA TRADERS” SH.P.K. themelohet nga Ortaket:

Z. Sukhwinder Singh, shtetas indian, lindur më 20.11.1995 ne Kishanpura, Punjab, Indi, rezident ne Punjab, Indi, mbajtes i Pasaportes me Nr. T7431126 me zotesi te plete per te vepruar;

Z. Jagseer Singh, shtetas indian, lindur më 05.10.1986 ne Demru Kalan, Punjab, Indi, rezident ne Punjab, Indi, mbajtes i Pasaportes me Nr. U7772352 me zotesi te plete per te vepruar;

Z. Ajay Kumar, shtetas indian, lindur më 24.03.1999 ne Jagatpur Jattan, Punjab, Indi, rezident ne Punjab, Indi, mbajtes i Pasaportes me Nr. P9258342 me zotesi te plete per te vepruar;

Z. Harpreet Singh, shtetas indian, lindur më 20.11.1987 ne Tanda Urmari Hoshiarpur, Punjab, Indi, rezident ne Punjab, Indi, mbajtes i Pasaportes me Nr. Z4611848 me zotesi te plete per te vepruar;

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

Neni 2
Emërtimi

2.1 Emërtimi i shoqërisë është “APRA TRADERS” SH.P.K.

Neni 3
Forma ligjore

3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4
Baza ligjore

4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5
Kohëzgjatja e veprimtarisë

5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qëndrën Kombëtare të Biznesit (“QKB”).

5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pacaktuar.

Neni 6
Selia

6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Besim Alla, Pallati Alfa, Hyrja 4, Zyra nr.14, Njesia Administrative nr.14, Tirane.

6.2 Shoqëria mund të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësimi si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj.

6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

Neni 7

Emblema. Vula

7.1 Shoqëria do të ketë emblemën dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.

7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.

7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përbajnjë emblemën dhe vulën e saj.

Neni 8

Objekti

8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:

Aktivitet ne fushen e pasurive te paluajtshme. Marrje me qera, blerje dhe investime ne fushen e strukturave te akomodimit brenda dhe jashte vendit. Tregtim i materialeve te ndertimit.

Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

Neni 9

Kapitali

9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 ALL (Njeqind mijë ALL).

9.2 Kapitali ndahet në 4 (kater) pjesë.

- Ortaku themelues **Z. Sukhwinder Singh** zoterues i një kuote me vlerë te pergjithshme 25 000 ALL qe perben 25% te kapitalit
- Ortaku themelues **Z. Ajay Kumar** zoterues i një kuote me vlerë te pergjithshme 25 000 ALL qe perben 25% te kapitalit
- Ortaku themelues **Z. Jagseer Singh** zoteruese i një kuote me vlerë te pergjithshme 25 000 ALL qe perben 25% te kapitalit
- Ortaku themelues **Z. Harpreet Singh** zoterues i një kuote me vlerë te pergjithshme 25 000 ALL qe perben 25% te kapitalit

9.3 Pjesa e kapitalit zotërohen 100% nga Ortaket.

9.4 Kapitali është shlyer tërësisht.

Neni 10

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

10.1 Kuotat e kapitalit mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;

10.2 Pjesët e kapitalit mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” me amendimet perkatese.

10.3 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi pjesët e kapitalit në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblese se Pergjithshme.

Neni 11

Rritja e kapitalit

11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rindërtuar. Ortakët e rindërtuar pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

Neni 12
Zvogëlimi i kapitalit

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.
- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përparrë marres së vendimit nga Asambleja e Pergjithshme e shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblese se Pergjithshme raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.
- 12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Asamblese se Pergjithshme të shoqërisë.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13
Vendimet e Asamblese se Pergjithshme

- 13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren prej Asamblese se Pergjithshme.
- 13.2 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme përfshijnë kryesisht:
- Ndryshimin e selisë ose të emërtimit të shoqërisë;
 - Rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - Shitjen ose transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar palëve të treta;
 - Prishjen dhe likujdimin e shoqërisë;
 - Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
 - Emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
 - Miratimin e bilancit të shoqërisë;
 - Transformimin e shoqërisë në formë të tjera.
 - Vendimarrijen per investime te reja ne fushen e pasurive te paluajtshme brenda apo jashte territorit shqiptar.

Neni 14
Administrimi

- 14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Asamblese se Pergjithshme.
- 14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Asamblese.
- 14.3 Administratori i shoqërisë eshte Z. Harpreet Singh, shtetas indian, lindur më 20.11.1987 ne Tanda Urmari Hoshiarpur, Punjab, Indi, rezident ne Punjab, Indi, mbajtes i Pasaportes me Nr. Z4611848 me zotesi te plote per te vepruar;
- 14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
 - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
 - Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
 - Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;
 - Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj.
 - Administratori ka të drejtë për ta përfaqësuar shoqërinë në Shqipëri apo kudo jashtë saj tek palët e treta, institucione apo entitete publike ose private,
 - Të lidhë, për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;

- Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm përmbarëvajtjen e biznesit;
 - Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelistët dështuese dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar,
 - Të hape dege ose zyre perfaqësimi, që konsiderohen te nevojshëm përbiznesin e shoqërisë.
- 14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm përpesë vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

Neni 15 Viti financiar

15.1 Viti financiar i shoqërisë përpushton me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.

15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 16 Bilanci. Kontabiliteti.

16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Pergjithshme dhe duhet të përgatitet përtuajtur para organeve tatumore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkësave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.

16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblese se Pergjithshme.

Neni 17 Te Ardhurat. Dividendi

17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përpunje me kërkësat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahanë ndërmjet ortakëve në raport më pjesët që ata zoterojnë në kapitalin e shoqërisë.

17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

Neni 18 Likujdimi

18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Asamblese.

18.2 Me vendimin e Asamblese caktohet një likujdator ose një grup likujdatorësh që do të plotësojnë procedurat e likujdimit.

18.3 Likujdatori do të përgatisë raportin e likujdimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rrëth operacioneve të mëtejshme të likujdimit dhe kohën që nevojitet përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedurë, Asambleja do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likujdimit.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtronen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Tiranë, datë 03.11.2021

ORTAKET:

Z. Sukhwinder Singh

SUKHWINDER SINGH

Z. Jagseer Singh

JAGSEER SINGH

Z. Ajay Kumar

AJAY KUMAR

Z. Harpreet Singh

HARPREET SINGH

Sukhwinder Singh
Sukhwinder Singh
Jagseer Singh

Ajay Kumar
Ajay Kumar